


# PLANI I INTEGRITETIT

Komuna e Gjakovës  
2015 – 2016

Mars 2015



**Plani i integritetit**  
**Komuna e Gjakovës**  
**2015 – 2016**

Mars 2015

## **PËRMBAJTJA**

<b>MIRËNJOHJE .....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>SHKURTESAT .....</b>	<b>5</b>
<b>DEKLARATA E INTEGRITETIT.....</b>	<b>6</b>
<b>PLANI PËR INTEGRITET.....</b>	<b>9</b>
<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK I: Përforsimi i rezistencës ndaj cënimit të integritetit .....</b>	<b>14</b>
<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK II: Procese me integritet në komunë .....</b>	<b>20</b>
<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK III: Komunikimi efektiv dhe përfshirja e bashkëpunëtorëve.....</b>	<b>37</b>
<b>PLANI I VEPRIMIT .....</b>	<b>41</b>

## MIRËNJOHJE

### Grupi punues i Komunës së Gjakovës:

- Mimoza Kusari Lila, Kryetare e Komunës
- Armend Vokshi, drejtor në Drejtorinë e Administratës
- Basri Komoni, drejtor në Drejtorinë e Shëndetësisë
- Diana Qarkagjia, drejtor në Drejtorinë e Arsimit
- Mentor Sylmetaj, drejtor në Drejtorinë e Inspektionit
- Silvana Domi, drejtore në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik
- Skender Tullumi, drejtor në Drejtorinë e Kadastrit
- Teki Shala, drejtor në Drejtorinë për Buxhet dhe Financave
- Xhelal Hoxha, drejtor në Drejtorinë e Urbanizmit

Dokumenti është hartuar me mbështetje nga Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Ekipi i Projektit të UNDP-së *Mbështetje përprojekte kundër korrupsionit në Kosovë* (SAEK).

*Plani i Integritetit për Komunën e Gjakovës (2015)* është përgatitur dhe publikuar me ndihmën bujare të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në Kosovë. Ndërsa është mbështetur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë.



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra  
**Swiss Cooperation Office Kosovo**

Mohim përgjegjësie: Përmbajtja e këtij dokumenti nuk paraqet medoemos pikëpamjet e UNDP-së apo SDC-së. Hartimi i dokumentit është realizuar bashkërisht nga Komuna e Gjakovës, Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Ekipi i Projektit SAEK të UNDP-së.

## **SHKURTESAT**

<b>AKK</b>	Agjencia Kundër Korrupsion
<b>FERMA</b>	Federata e Shoqatave Evropiane të Menaxhimit të Rrezikut
<b>IKAP</b>	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
<b>ISO</b>	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
<b>MBNJ</b>	Menaxhimi i burimeve njerëzore
<b>ZHBNJ</b>	Zhvillimi i burimeve njerëzore
<b>OSHC</b>	Organizatat e Shoqërisë Civile
<b>PLANI</b>	Plani për Integritet
<b>SAEK</b>	Mbështetje Përpjekjeve Kundër Korrupsion
<b>SDC</b>	Agjencia Zvicrane për Bashkëpunim dhe Zhvillim
<b>SMI</b>	Sistem i menaxhimit të integritetit
<b>TI</b>	Transparency International
<b>UNDP</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

## DEKLARATA E INTEGRITETIT

Ne, në Komunën e Gjakovës, jemi krenarë që përfaqësojmë një komunitet me një histori të veçantë që ka shfaqur shumëllojshmëri kulturore dhe përzierje të mundësive suburbane dhe rurale.

Ne jemi një komunitet progresiv me ekonomi të diversifikuar, që përfshin veprimtari ekonomike të bazuara në resurse tradicionale si dhe frymën e ndërmarrësisë që kontribuon në mundësi të reja ekonomike. Për tu zhvilluar dhe rritur më tej si komunitet që njeh vlerën e zhvillimit të qëndrueshëm, sundimin e ligjit dhe cilësinë e jetës, ne, në komunën e Gjakovës, jemi të vendosur që të veprojmë me integritet të pakompromis në çdo gjë që bëjmë. Suksesi ynë do të ndërtohet në një punë të fortë etike, marrëdhënie të përgjegjshme dhe produktive pune me komunitetin tonë dhe partnerët vendorë e ndërkombëtarë.

Ne e njohim shkallën dhe kompleksitetin e korrupsionit dhe çështjet e integritetit me të cilat përballet komuna jonë. Komuna jonë është punëdhënës i rëndësishëm vendor, ka buxhet të konsiderueshëm dhe është e përfshirë në dhjetëra transaksione çdo javë. Kështu, ajo është thellësisht e ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme dhe të rënda të korrupsionit. Zyrtarët publikë gëzojnë kompetenca të konsiderueshme diskrecionare dhe monopol mbi shërbimet publike siç janë zhvillimi lokal ekonomik, shëndetësia, arsimi, banimi, toka, uji, etj. Nivelet e larta të burokrasisë administrative, kombinuar me bashkëveprime të ngushta në pikën e ofrimit të shërbimit mund të ofrojnë mundësi të shumta për korrupsion. Lidhjet e partive politike, grupet e interesit të pushtetit lokal dhe rrjetet sociale, kombinuar me një shumëllojshmëri të pikave të bashkëveprimeve ndërmjet sektorit publik dhe atij privat, sigurojnë një sfond të pasur për presion të korrupsionit. Kornizat komplekse dhe disa herë jokoherente rregullative rrezikojnë aplikimin e vazhdueshëm të sundimit të ligjit dhe në këtë mënyrë mbajnë hapur dyert për shkelje të integritetit. Procedurat e rënda administrative paraqesin kërcënim shtesë për shërbimet efektive dhe efikase.

Duke pasur këtë parasysh, ne e kuptojmë në tërësi mandatin tonë për luftimin e korrupsionit në nivel lokal. Deri më sot, përmes politikave dhe masave tona të menaxhimit të integritetit, Komuna po bën përpjekje të mëdha për ta rritur rezistencën organizative ndaj korrupsionit dhe shkeljeve të tjera të integritetit dhe kështu të rrisë në masë të madhe jo vetëm performancën e saj të integritetit, por edhe efikasitetin, efektivitetin, transparencën dhe cilësinë e lidhur të shërbimeve të ofruara publike. Ne jemi të vendosur që t'i bashkojmë njerëzit, partneritetet dhe mundësitë për një Komunë të Gjakovës të fortë, vibrante dhe të rezistente ndaj shkeljeve të integritetit.

*Për komunitetin tonë:*

Ne i mbajmë zotimet tona karshi palëve tona të interesit dhe e fitojmë besimin duke vepruar me integritet dhe sjellë në mënyrë etike. Duke marrë parasysh qëndrueshmërinë dhe pasojat afatgjata të veprimeve, ne e lidhim integritetin me shqetësime të tjera; mendojmë gjerësisht për të gjithë sektorët e çështjeve, dhe veprojmë në përputhje me rrethanat. Gjithashtu, synojmë të jemi Komunë që me veprimet e saj dëshmon vlerësim të thellë për të kaluarën e komunitetit, i përgjigjet nevojave aktuale dhe përgatitë plane për të ardhmen tonë kolektive.

*Për qytetarët tonë:*

Ne përpiqemi të ofrojmë shërbime cilësore në fushat që janë në kompetencë të komunës në kohë të duhur, në mënyrë efektive dhe efikase dhe duke respektuar standardet më të larta të integritetit profesional. Për të marrë informata nga mjete të ndryshme të mbikëqyrjes së qytetarëve, ne nxisin realizimin e sondazheve të kënaqshmërisë së konsumatorëve dhe linjat telefonike kundër korrupsionit si mjete funksionale për informata kthyesë dhe mekanizma të raportimit.

*Për stafin tonë:*

Ne i çojmë njerëzit tonë, e nxitim zhvillimin e tyre dhe shpërblejmë punën e tyre. Ne jemi të përgjegjshëm – individualisht dhe kolektivisht – për sjelljen tonë etike, veprimet dhe performancën e integritetit. Është përgjegjësi e të gjithë stafit që t'i raportojnë të gjitha incidentet e korrupsionit, apo shkeljet tjera të integritetit. Të gjitha këto do të trajtohen me konfidencialitet të plotë dhe nuk bëhen publike dhe nuk diskutohen me palët e tjera përveç atyre që janë ngarkuar me hetimin. Përveç kësaj, megjithatë, çdo punonjës është përgjegjës që të kontribuojë në performancën e integritetit komunal duke vepruar si menaxher i rrezikut brenda zonës së saj/tij të kompetencës.

*Për institucionin tonë:*

Ne e vlerësojmë besimin që na është dhuruar nga qytetarët dhe të gjitha veprimet tona duhet të reflektojnë kujdes dhe integritet në menaxhimin e burimeve publike. Kënaqëshmëria e qytetarëve me shërbimet komunale është matje e rëndësishme e suksesit tonë si organizatë. Bashkëpunimi me të gjithë sektorët e komunitetit është i nevojshëm për ta përmirësuar mirëqenien e komunitetit, prandaj dhe shërbimet duhet të sigurohen në mënyrë të përgjegjshme fiskale dhe llogaridhënese.

Ne jemi të vendosur të aplikojmë një politikë të “tolerancës zero” ndaj korrupsionit. Çdo shkelje e zbuluar do të hetohet, sipas nevojës, dhe do të ndërmerren veprimet e duhura kundër atyre që janë përgjegjës.



Për më tepër, ne përpiqemi të zhvillojmë, dokumentojmë, zbatojmë dhe vazhdimisht të përmirësojmë një sistem funksional të menaxhimit të integritetit si mjet të domosdoshëm për parandalimin e shkeljeve të integritetit dhe rritjen e performancës së integritetit komunal. Plani i Integritetit është hap kritik, por jo fundi i përpjekjeve tona kundër korrupsionit dhe do të bëjmë çdo gjë që është e nevojshme për të siguruar që masat zbatohen, rreziqet rishikohen periodikisht dhe rreziqet e informuara të integritetit bëhen pjesë e kulturës organizative të Komunës së Gjakovës.

Ne shpresojmë që përvoja jonë do të japë vlerë të shtuar në procesin e futjes së planifikimit të integritetit në sektorin publik të Kosovës dhe do të shërbejë si model shembullor për të gjitha komunat e Kosovës. Ne presim që veprimet tona të jenë në përputhje me fjalët që i themi, që fjalët tona që të jenë në përputhje me synimet tona. Ne mbajmë veten përgjegjës për fjalët dhe veprimet tona.

Unë, me këtë rast, deklaroj mbështetjen time të pakushtëzuar dhe zotimin e fortë për të gjitha përpjekjet për forcimin dhe zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të integritetit në Komunën e Gjakovës.

Mimoza Kusari Lila  
Kryetare e Komunës së Gjakovës

2015

## PLANI PËR INTEGRITET

Plani Integriteti është dokument *strategjik*, si dhe *operacional* që mbështetë rezultatet e procesit të vlerësimit të rrezikut të integritetit të ndërmarra në Komunën e Gjakovës. Plani tregon përkushtimin e Komunës në përmirësimin e mëtejshëm të kontrolleve ekzistuese operacionale në spektrin e plotë të aktiviteteve të realizuara, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Për këtë qëllim, ai saktëson masat e bazuara në rrezik për përmbushjen e objektivave të saj të integritetit dhe forcimin e sundimit të ligjit dhe vlerave dhe standardeve profesionale.

Ky Plan do të luajë rol vendimtar për Komunën e Gjakovës, për të:

- Rritur mundësinë e përmbushjes së objektivave organizative, inkurajuar menaxhim proaktiv, jo reaktiv, të rrezikut të integritetit; minimizuar humbjen nga shkeljet e korrupsionit dhe integritetit, reduktuar/eliminuar mundësitë për korrupsion dhe përmirësuar rezistencën organizative ndaj korrupsionit;
- Mbajtur fokusin mbi prioritetet, bazuar në identifikimin dhe vlerësimin e informuar të rrezikut që do të ndihmojë Komunën në shpërndarjen efektive të burimeve të kufizuara kundër korrupsionit që janë në dispozicion, për përdorim sa më të mirë;
- Siguruar respektim të vazhdueshëm me kërkesat përkatëse ligjore dhe procedurale dhe standardet kryesore ndërkombëtare të menaxhimit;
- Ndërtuar/forcuar kapacitetet për përpjekje efektive kundër korrupsionit, ngritur vetëdijen në të gjitha nivelet dhe krijuar bashkëpronësi në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të planeve të integritetit;
- Përmirësuar besimin e palëve të jashtme dhe të brendshme të interesit dhe për t'iu përgjigjur kërkesave dhe pritjeve të tyre në lidhje me performancën e integritetit të Komunës.

Plani bazohet në *rezultatet e një procesi gjithëpërfshirës të planifikimit të integritetit dhe vlerësimit të rrezikut* të realizuar në kuadër të Komunës së Gjakovës në periudhën korrik 2014 – shkurt 2015. Ky proces përfshinte *identifikimin* e cenueshmërive organizative ndaj shkeljeve të integritetit, dhe *vlerësimin* e tyre duke konsideruar (1) dëmin në kuptim material dhe jomaterial që shkaktojnë shkeljet e mundshme përkatëse, dhe (2) mundësinë që ngjarjet e tilla të mund të ndodhin, përmes rezistencës aktuale organizative të mbështetur në rregulloret, procedurat, kodet, praktikat përkatëse dhe përfshirjen e stafit. Për t'i përmbushur pikat e sipërpërmendura, Komuna ka ndërmarrë veprimet vijuese:

- Janë caktuar përgjegjësi të qarta për vlerësimin e rrezikut të integritetit përmes themelimit të Grupit Punues të kryesuar nga Kryetarja e Komunës së Gjakovës, duke shfaqur kështu dëshmi të fortë të përkushtimit për integritet;
- Është analizuar korniza përkatëse kigjore, rregullative dhe operacionale e Komunës;
- Janë analizuar të dhënat nga performanca, monitorimi dhe zbatimi i integritetit;
- Është analizuar kënaqshmëria e klientëve dhe perceptimi i korrupsionit tek sektori i qeverisë lokale, duke përfshirë anketa/raporte të realizuara nga organizata ndërkombëtare;
- Është proceduar një anketë vetëvlerësimi e organizatës për të siguruar informata dhe të dhëna të vlefshme për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të integritetit në komunë; bazuar në rezultatet, janë identifikuar fushat e rrezikut dhe linjat dhe masat operacionale të përmirësimit;
- Bazuar në të dhënat e fituara nga anketat është zhvilluar sistemi i integritetit organizativ;
- Është mbajtur një fokus grup ku janë përpunuar tabelat e veçanta të rrezikut për trajtimin e rreziqeve specifike në njësitë kryesore administrative dhe fushat me rrezik të lartë për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të integritetit dhe janë listuar masat për avancim. Si rezultat, janë hartuar Regjistri i Rrezikut të Integritetit dhe Tabelat e Rrezikut;
- Janë përdorur dokumentet/udhëzimet për zhvillimin e integritetit të UNDP-së, Praktikat më të mira të integritetit, doracakë të Transparency International, standardet e menaxhimit të rrezikut ISO 31000 dhe FERMA, specifikimi BS 10500 për sistemin e menaxhimit kundër rryshfetit; standardi Australian/Zelandës së Re kundër korrupsionit – AS 8001-2008; Udhëzimet ISO 26000 për përgjegjësinë sociale; Parimet e punës të Transparency International për kundërvënien të rryshfetit; Kërkesat e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001 dhe Menaxhimi i Informacionit të Sigurimit ISO 27001, për të bashkërenduar Planin e Integritetit me praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare.

Si shtesë Strategjisë Kosovare Kundër Korrupsionit dhe të Planit të Veprimit, ky Plan i Integritetit do të realizohet përgjatë viteve 2015-2016, në përputhje me ciklin e radhës të planifikimit strategjik kundër korrupsionit.

Një buxhet i veçantë për zbatimin e këtij Plani të integritetit do të ndahet në përputhje me *Planin e Veprimit* të hartuar dhe të bashkëlidhur (Shtojca 1).

Zbatimi i tij do të monitorohet në format të strukturuar, do të rishikohet periodikisht dhe përditësohet në përputhje me zhvillimet përkatëse normative, institucionale, procedurale dhe

të stafit në kuadër të mjedisit të ndryshuar të jashtëm dhe të brendshëm organizativ. *Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit* është i rëndësishëm për të siguruar që masat e kontrollit të rrezikut të integritetit dhe trajtimit janë efektive edhe në kuptim të projektimit edhe operimit; se procedurat janë kuptuar dhe se plani integritetit respektohet. Përveç kësaj, monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e propozuara të trajtimit të rrezikut që kanë prodhuar efektet e synuara; nëse ato mund të zbulojnë ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm, duke përfshirë ndryshimet në vetë rrezikun që mund të kërkojnë rishikim të trajtimeve të rrezikut dhe prioriteteve; të identifikojë se çfarë mësimi mund të nxirren për planifikim të ardhshëm.

Përgjegjësitë për monitorim të rregullt të Planit janë caktuar për \_\_\_\_\_.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se janë arritur rezultatet e planifikuara. \_\_\_\_\_ do të jetë përgjegjëse për të raportuar në baza periodike tek Kryetari/ja i/e Komunës së Gjakovës për progresin e zbatimit. Shpeshtësia minimale e raportimit është çdo gjashtë muaj. Raportimi i mundëson Kryetares së Komunës që të ndër marrë me kohë masa përmirësuese/parandaluese në rast se zbatimi i ndonjë mase/masave të caktuara sjell vështirësi/vonesa.

Në veçanti, Plani i Integritetit:

- Përmban Deklaratën e Integritetit e cila rithekson zotimin për integritet nga ana e Komunës së Gjakovës.
- Shpjegon prapavijën, fushëveprimin, qëllimin, objektivat dhe metodologjinë që është përdorur për hartimin e Planit të Integritetit. Paraqet aspektet kryesore të procedurave përkatëse për zbatim, monitorim dhe raportim.
- Përmban objektivat strategjike, aktivitetet dhe masat të cilat shpalosin objektivat kryesore strategjike dhe përmbledh fushat e veprimit që synojnë të fuqizojnë mbrojtjen e integritetit në Komunën e Gjakovës.
- Përmban Planin e Veprimit që në hollësi shpalos të gjitha masat që do të merren për të arritur objektivat e caktuara, si dhe kornizën kohore përkatëse dhe përgjegjësitë organizative për zbatim. Indikatorët e suksesit për secilën masë duhet të përcaktohen saktësisht dhe të mbështeten nga burimet/financat e nevojshme.

Ne besojmë se përmes zhvillimit dhe zbatimit të këtij Plani, Komuna e Gjakovës do të jetë në pozitë më të mirë që të sigurojë realizim efektiv, efikas dhe etik të rezultateve të tyre të synuara, duke përfshirë përmirësimin e shërbimeve publike dhe rritjen e kënaqësisë së palëve të interesit. Megjithatë, hartimi i këtij Plani shihet si baza e përpjekjeve të mëtejshme për

zotëruar një *sistem funksional të menaxhimit të integritetit* (në tekstin e mëtejme, SMI). Sistemet e tilla janë gjithnjë e më të njohur në sektorët publikë, privatë dhe joqeveritarë, si dhe perceptohen si çelës për zvogëlimin e shpenzimeve të pazgjidhura ekonomike dhe njerëzore të shkeljeve të integritetit, rritjen e biznesit në të ardhmen dhe rritur reputacionin dhe kredibilitetin organizativ. Sigurimi i integritetit do të jetë vendimtar për aftësinë e komunës për t'i përmbushur angazhimet e saj në praktikë karshi palëve të interesit, ku planifikimi i integritetit është shtyllë themelore.

## OBJEKTIVAT STRATEGJIKE, LINJAT E AKTIVITETEVE DHE MASAT

Aktualisht, Komuna e Gjakovës është duke kaluar nëpër një proces intensiv të zhvillimit, dokumentimit dhe zbatimit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, në përputhje me kërkesat ISO 9001: 2008. Kjo përpjekje për të futur një menaxhim me fokus në performancë, dhe të bazuar në proces, mbështetur nga zotimi i menaxhmentit të lartë dhe përfshirja e madhe e stafit, siguron një bazë të shëndoshë për avancimin e menaxhimit të integritetit në vitet e ardhshme. Në hapat e ardhshëm, Komuna e Gjakovës do t'i përforcojë masat për rritjen e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit duke u përqendruar në tre fushat kryesore si në vijim:

- Forcimi i rezistencës ndaj shkeljeve të integritetit, dhe rritja e efikasitetit, efektivitetit dhe transparencës së sistemit tërësor të menaxhimit komunal përmes përmirësimit të menaxhimit të funksionit të rrezikut të integritetit dhe përmirësimit të praktikave të menaxhimit të integruar;
- Krijimi i mjedisit të brendshëm për të mbështetur proceset komunale të shëndosha nga aspekti i integritetit, përmes kontrolleve të optimizuara të integritetit në nivel të procesit strategjik dhe operacional dhe ndërtimit/forcimit të kapaciteteve, njohurive dhe aftësive lokale në menaxhimin e integritetit;
- Përmirësimi i mjedisit të jashtëm për të përforcuar dhe zgjeruar aspektet e integritetit në proceset e modernizimit dhe reformës përmes bashkërendimit të përmirësuar me qytetarët, bizneset dhe aktorët e tjerë kyçë, komunikimit të strukturuar dhe efektiv; promovimit të transparencës dhe angazhimit të palëve të interesit; shpërndarjes së praktikave të mira dhe angazhimit të përbashkët.

Në vijim paraqiten dhe shpjegohen objektivat e lartpërmendura strategjike dhe këto objektiva përkthehen në linja të aktiviteteve konkrete të politikave dhe menaxhimit dhe në masa që përkrahin arritjen e tyre.

**OBJEKTIVI STRATEGJIK I:**

**Forcimi i rezistencës ndaj shkeljeve të integritetit, dhe rritja e efikasitetit, efektivitetit dhe transparencës së sistemit tërësor të menaxhimit komunal përmes përmirësimit të menaxhimit të funksionit të rrezikut të integritetit dhe përmirësimit të praktikave të menaxhimit të integruar**

**Linjat e aktivitetit dhe masat përkatëse**

- 1.1. Përmirësimi i menaxhimit të funksionit të rrezikut integriteti përmes planifikimit të brendshëm të integritetit si praktikë e qëndrueshme dhe zhvillimit dhe zbatimit progresiv të një sistemi funksional të menaxhimit të integritetit**

**Arsyeshmëria:** Në Komunën e Gjakovës, planifikimi i integritetit është në zhvillim e sipër si hap kritik drejt menaxhimit efektiv të rrezikut të integritetit. Për të pasur një sistem funksional të menaxhimit të integritetit, kërkohet që Komuna të zbatojë më tej kornizën e përmirësimit të vazhdueshëm Planifikim – Bërje – Kontrollim – Veprim (PBKV) dhe të përfshijë menaxhimin e integritetit në praktikat rutinore të menaxhimit. Kjo nënkupton që të (1) të *planifikojë* politikat/masat e saj të integritetit; (2) të *zbatohet* plani dhe kontrollet e lidhura operative, (3) të *kontrollojë*, *monitorojë* dhe *masë* karakteristikat kryesore të operacioneve që përcaktojnë performancën organizative; dhe (4) të *ndërmarrë veprime* për ta përmirësuar vazhdimisht performancën e integritetit organizativ dhe SMI. Duke punuar drejt SMI do të ndihmojë në krijimin/forcimin e kompetencës në menaxhimin e integritetit dhe vetëdijesimin e përgjithshëm kundër korrupsionit. Ndonëse SMI nuk mund të ofrojë siguri absolute që nuk ka ndodhur apo nuk do të ndodhë asnjë korrupsion në lidhje me Komunën, ai mund ta ndihmojë organizatën që të parandalojë dhe zbulojë praktikat abuzuese. Gjithashtu, do të demonstrojë që Komuna ka zbatuar masa të arsyeshme dhe proporcionale për ta ndihmuar atë në përmbushjen e obligimeve të saja ligjore dhe aspiratave etike .

**Masat:**

- 1.1.1. Të gjithë pjesëtarët e stafit të jenë në *dijeni* për aprovimin e Deklaratës së Integritetit dhe Planit të Integritetit, duke përfshirë ndarjen e përgjegjësive të zbatimit dhe afati kohor përkatës. Nëse është e përshtatshme, të konsiderohet publikimi i deklaratës së integritetit përmes kanaleve të brendshme dhe të

jashtme të komunikimit të organizatës për të komunikuar edhe me palët e jashtme të interesit.

- 1.1.2. Të përcaktojë qartë *përgjegjësinë dhe autoritetin për funksionin e përmbushjes së integritetit* në Komunën e Gjakovës. Për këtë qëllim, të caktohet përgjegjësia dhe autoriteti për: mbikëqyrjen e zbatimit të SMI dhe Planit Integritetit; ofrimin e këshillave dhe udhëzimeve për stafin e SMI dhe çështjet që kanë të bëjnë me integritetin; raportimin mbi performancën e menaxhmentit të lartë. Funksioni i përmbushjes së integritetit do të përbëhet nga zyrtarë që kanë kompetenca, status, autoritet dhe pavarësi të duhur.
- 1.1.3. Të rishikohet nevoja për të *zhvilluar rregulla të brendshme në fushat kryesore të parandalimit të integritetit: deklarimi i interesit, angazhimet jashtë punës, deklaratimet e pasurive, dhuratave dhe mikpritjes*, krahas Kodit ekzistues të Mirësjelljes dhe rregulloreve të aplikueshme vendore. Zhvillimi i rregullave që konsiderohen të nevojshme për t'i mbuluar zonat e mësipërme parandaluese në mënyrë adekuate. Të *sigurohet nivel i mjaftueshëm i njohjes* së të gjithë stafit me të gjitha rregullat ekzistuese *mbi konfliktin e interesit, angazhimet jashtë punës, deklaratimet e pasurive, dhuratave dhe mikpritjes* përmes trajnimeve të duhura dhe aktiviteteve të ngritjes së vetëdijes. Të mbahet një *Regjistër i dhuratave* të Komunës si dhe të sigurohet që punonjësit janë të vetëdijshëm për ekzistencën e Regjistrit të dhuratave dhe kuptojnë në tërësi detyrimet e tyre përkatëse. Për ta shtuar fokusin në parandalim, të publikohen *rezultatet e hetimeve* për shkelje të Kodit të sjelljes brenda Komunës, nëse ka të tilla, duke shpalosur rreziqet/tendencat/shtytësit.
- 1.1.4. Të themelohet dhe mbahet një sistem i strukturuar i *brendshëm dhe i jashtëm relevant për SMI*, duke përfshirë: çfarë do të komunikojnë; kur të komunikojë; me kë të komunikojë; si të komunikojë. Të integrohen aspektet e integritetit në politikat/praktikat e komunikimit të brendshëm.
- 1.1.5. Të themelohet dhe mbahet një sistem që mundëson *raportim konfidencial* të shkeljeve të integritetit. Për këtë qëllim, në përputhje me rregulloret përkatëse kombëtare, të miratohet një Politikë të Bilbilfryrësve për Komunën e Gjakovës, që përcakton procedurën e detajuar që duhet të ndiqet në mënyrë që të raportohen të gjitha rastet e mashtrimit dhe/ose korrupsionit. Kjo politikë t'i komunikohet të gjithë stafin, për të mbështetur të kuptuarit koherent, qëndrimet pozitive dhe zbatimin efektiv.
- 1.1.6. Të sigurohet *Rivlerësimi i rreziqeve të integritetit në intervale të planifikuara dhe sipas nevojës*, pra para përfundimit të Planit të tanishëm të Integritetit për të përgatitur bazën për Planin e ri të Integritetit, si dhe rishikime periodike të



aktiviteteve të njëjse me funksione të kontrollit në fushat me nivelet më të larta të rrezikut, sipas nevojës.

- 1.1.7. Të sigurohet një *monitorim* i strukturuar i brendshëm i *performancës së integritetit të* Komunës brenda intervaleve të planifikuara (p.sh. çdo tre muaj) dhe të sigurohet që rezultatet raportohen tek menaxhmenti lartë dhe që janë marrë masat e nevojshme korrigjuese;
- 1.1.8. Të institucionalizohet rishikimi i sistemit të menaxhimit të integritetit – të rishikohen në periudha të planifikuara (p.sh. çdo vit) të dhënat e futura në lidhje me performancën e SMI (d.m.th. të zbatimit të objektivave dhe masave, ndryshimet në çështjet e jashtme dhe të brendshme që janë të rëndësishme për sistemin e menaxhimit të integritetit; informata mbi integritetin performancës, duke përfshirë trendët e: mospërputhjeve dhe veprimeve korrigjuese, monitorimin dhe matjet e rezultateve, sfidat dhe rekomandimet për përmirësim, etj.) dhe të merren vendime në lidhje me efektivitetin e rritur të SMI. Rezultatet e rishikimit të menaxhimit do të përfshijnë vendimet që kanë të bëjnë me mundësitë e përmirësimit të vazhdueshëm dhe nevojat për ndryshime në Planin e Integritetit dhe sistemin e menaxhimit të integritetit. Të maksimizohen mundësitë për t'i komunikuar rezultatet e zbatimit tek një spektër i gjerë i palëve të interesit përmes formateve të përshtatshme të komunikimit: publikimeve në faqe të internetit, raporte informuese, etj.

**1.2. Integrimi progresiv i aspekteve të SMI në sistemin e menaxhimit të cilësisë është zbatuar për ta optimizuar performancën e integritetit, nxitur fokusin tek konsumatorët dhe për kufizimin efektiv të mundësive për shkelje të integritetit**

**Arsyeshmëria:** Komuna e Gjakovës ka zhvilluar, dokumentuar, zbatuar dhe certifikuar një Sistem të Menaxhimit të Cilësisë në përputhje me standardin ndërkombëtar ISO 9001: 2008. Instrumentet e Menaxhimit të Plotë të Cilësisë kanë dëshmuar efektet në avancimin e qeverisjes së sektorit publik në shumicën e vendeve të BE-së ku mjetet të ndryshme menaxhojnë aspekte të rëndësishme të menaxhimit publik – cilësinë, llogaridhënësin, integritetin, transparencën, efektivitetin dhe efikasitetin. Përderisa mjete të ndryshme janë krijuar për t'u përdorur në mënyrë të pavarur, ato mund të jetë një përputhje apo të integruara me sisteme të tjera të menaxhimit meqë bazohen në parimet e njëjta MPC, d.m.th. ciklit PDCA. Vlera e një modeli të menaxhimit të integruar të bazuar në standardin ISO 9001 dhe parimet e menaxhimit të integritetit mund të vërehen si në vijim. Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare siguron një fokus në kornizën e brendshme operacionale të cilësisë dhe integritetit. Për qytetarët, kjo do të thotë shërbime efikase dhe

efektive, sistemit informativ më transparent dhe staf profesional. Aplikimi i aspekteve SMI do të kufizojë në mënyrë efektive mundësitë për shkelje të integritetit. Integrimi i SMI me aspekte të cilësisë do të mundësojë ndërtimin e një sistemi të menaxhimit përgjatë një cikli PDCA që fuqizon cilësinë dhe integritetin. Integrimi do të mundësojë përdorim më efikas të burimeve dhe planifikim të integruar. Njohja përmes certifikimit (ISO 9001) ofron stimulime dhe shpërblime shtesë. Ajo do të *përcjellë* një mesazh të fortë edhe për klientët e brendshëm edhe ata të jashtëm të një zotimi të qartë të menaxhimit për integritet dhe shërbime me fokus tek klientët dhe transparenca.

### Masat:

- 1.2.1. Në përputhje me SMC të zbatuar, të zhvillohet dhe mirëmbahet një *regjistër i plotë dhe gjithëpërfshirës i proceseve të Komunës së Gjakovës. Të mbulohen të gjitha proceset kryesore strategjike, operationale dhe të mbështetjes* që janë të rëndësishme për cilësinë dhe integritetin, me *procedura* adekuate të brendshme të dokumentuara operationale, për ta ulur rrezikun nga gabimet, devijimet dhe shkeljet e integritetit. Këto procedura *t’iu komunikohen* të gjithë stafit, në mënyrë që të bëhen efektive në përdorim. Stafi të trajnohet sipas nevojës.
- 1.2.2. Të sigurohet që *Organogrami* mbulon qartas dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse pozitat dhe përgjegjësitë përkatëse dhe linjat e llogaridhënies për ta arritur transparencën dhe efikasitetin maksimal të operationeve.
- 1.2.3. Të përputhen *përshkrimet e vendeve të punës* me proceset themelore dhe procedurat përkatëse të punës, t’u komunikohen ato të gjithë pjesëtarëve të stafit. Të integrohen aspektet e integritetit në përshkrimet e vendeve të punës.
- 1.2.4. Të zhvillohen *tregues adekuatë të performancës* të proceseve kyçe komunale për ta vlerësuar progresin në ndikimin e reformave, për ti identifikuar problemet, mbështetur vendimmarrjen/proceset operationale, etj. Nëse është e mundur, të krijohet një sistem i automatizuar për monitorimin e treguesve të specifikuar të performancës.
- 1.2.5. Të fuqizohet fokusi tek konsumatorët, të tregohet përkushtim ndaj standardeve të larta profesionale të shërbimit dhe të maksimizohen mundësitë për mbikëqyrje të qytetarëve, të konsiderohet zhvillimi i një *Statuti të shërbimit për klientët e Komunës së Gjakovës*. Ky statut do të përçonte një mesazh të fortë për zotimin e komunës për ta mbajtur ekselencën profesionale dhe respektuar standardet e larta të sjelljes, për t’i informuar klientët mbi të drejtat dhe obligimet e tyre, përshkruar nivelin minimal të shërbimit, afatet dhe cilësinë e lidhur, dorëzuar ankesa, lavdërime dhe kanalet e informatave kthyesë. Ky statut i

Shërbimeve të Klientit të vendoset në pikat kryesore publike (p.sh. qendra të informimit, zona të ofrimit të shërbimeve) dhe të jetë i qasshëm përmes mediave të shkruara dhe atyre elektronike dhe në internet. *I tërë stafi të jetë në dijeni të standardeve të shërbimit të përfshira në Statut:*

- 1.2.6. *Të integrohen informatat kthyesë nga përdoruesit e shërbimeve në operacione për ta avancuar cilësinë e shërbimit dhe performancën e integritetit. Për këtë qëllim, nëse është e realizueshme, të planifikohen dhe realizohen anketa të kënaqshmërisë së konsumatorëve; kontrole të atypëratyshme, operacione të klientit të fshehtë, etj.*
- 1.2.7. *Të konsiderohen mundësitë për integrimin e menaxhimit të integritetit me autoritetin, rolet dhe përgjegjësitë e menaxhimit të cilësisë.*
- 1.2.8. *Të konsiderohen mundësitë për integrimin e rishikimit të menaxhimit të integritetit me rishikimin e menaxhimit të sistemit të cilësisë, kur janë duke u shqyrtuar edhe aspektet e cilësisë edhe ato të integritetit.*

### **1.3. Avancimi i mëtejshëm i sistemit të menaxhimit të realizuar në Komunën e Gjakovës përmes mbulimit adekuat të rreziqeve të lidhura me sigurinë e informacionit**

**Arsyeshmëria:** Vlerësimi i realizuar i rrezikut ka identifikuar rreziqet integritetit që kanë të bëjnë me sigurinë e informacionit në mesin e sfidave të mëdha për të mbajtur një SMI efektive. Nivelet aktuale të mbrojtjes së informatave të fshehta, si dhe atyre personale, konsiderohen të papërshtatshme, duke nisur kështu një platformë për reformën dhe agjendën e modernizimit. Mendohet që procesi i vazhdueshëm i strukturimit të cilësisë dhe sistemit të menaxhimit të integritetit mund të përdoret për të integruar sigurinë e aspekteve të informacionit në të. Praktikrat e mira ndërkombëtare (p.sh. Udhëzimet e OECD-së për Sigurinë e Informacionit dhe Rrjeteve, ISO/IEC 27001 që përkufizojnë kërkesat për krijimin, zbatimin, funksionimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e një Sistemi të dokumentuar të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit) ofrojnë referenca të konsiderueshme për ta udhëhequr procesin e ofrimit të menaxhimit efektiv të faktorëve të shumtë dhe kompleksë të rrezikut që kanë të bëjnë me sigurinë e informacionit. Jo të gjitha kërkesat mund të respektohen menjëherë, dhe të kenë burime të mjaftueshme me infrastrukturën ekzistuese njerëzore, financiare e teknike. Megjithatë, ato mund të bëhen bazë e mirë për një procesin progresiv të realizuar në faza të zhvillimit të një sistemi funksional për menaxhimin e sigurisë së informacionit si pjesë e sistemit tërësor të menaxhimit në Komunën e Gjakovës. Vlerësimi i rrezikut, struktura e sigurisë, menaxhimi dhe rivlerësimi i sigurisë janë ndër komponentët integrale të saj. Për të garantuar rezultate,

aplikimi i sistemit duhet të kontrollohet në mënyrë rigoroze, të monitorohet dhe auditohet rregullisht.

**Masat:**

- 1.3.1. Të zhvillohet një kornizë gjithëpërfshirëse referencë e bazuar në kriteret e përcaktuara nga praktikat e mira ndërkombëtare në dispozicion, në veçanti Udhëzimet e OECD-së për Sigurinë e Informacionit dhe Rrjeteve, dhe standardi i menaxhimit ISO/IEC 27001. Të Vlerësohet sistemi aktual kundrejt kornizës referencë, dhe bazuar në rezultate, të krijohet dhe zbatohet në faza Plani i Veprimit për Sigurimin e Informacionit në Komunën e Gjakovës. Plani do të specifikojë deklaratën komunale të sigurisë, si dhe masat specifike për të siguruar zgjedhjen e kontrolleve adekuate dhe proporcionale të sigurisë që mbrojnë asetet e informacionit. Të ndahen përgjegjësitë në lidhje me zbatimin e tij, si dhe burimet e nevojshme. Plani t'i komunikohet tërë stafit.
- 1.3.2. Të mbështetet zhvillimi i sistemit të sigurisë të informacionit përmes *eventeve të duhura të ngritjes së kapaciteteve dhe vetëdijesimit*. Për këtë qëllim, të konsiderohet krijimi/fuqizimi i kapaciteteve komunale për menaxhimin e sigurisë së informacionit (p.sh. trajnime në ISO 27001 për stafin e zgjedhur). Të krijohet një sistem i ngjarjeve të ndërgjegjësimit/ kanaleve të rregullta të mentorimit për të siguruar që stafi është sensibilizuar rregullisht mbi rreziqet e integritetit që kanë të bëjnë me sigurinë e informacionit dhe shfrytëzimin e burimeve të kompjuterit, në veçanti – kontrollit të qasjes.

**OBJEKTIVI STRATEGJIK II:**

**Mundësimi i mjedisit të brendshëm për të mbështetur proceset komunale të shëndosha nga aspekti i integritetit, përmes kontrolleve të optimizuara të integritetit në nivel të procesit strategjik dhe operacional dhe ndërtimit/forcimit të kapaciteteve, njohurive dhe aftësive lokale në menaxhimin e integritetit**

**Linjat e aktivitetit dhe masat përkatëse**

**2.1. Rritja e rezistencës ndaj shkeljeve të integritetit përmes fuqizimit të kontrolleve operacionale të integritetit në proceset kyçe me rrezik të lartë të menaxhimit dhe mbështetjes**

**Kuvendi Komunal**

**Arsyeshmëria:** Kuvendi Komunal i zgjedhur drejtpërsëdrejti është organi më i lartë në kontekstin komunal. Ai ushtron funksione kritike me rrezik të lartë të integritetit ashtu si përcaktohet në LVQL dhe Statutin Komunal, si p.sh. në lidhje me miratimin e buxhetit dhe planet e investimit; nivelin e taksave, tarifave dhe pagesave komunale; vendimet që kanë të bëjnë me pronën komunale; aprovimin dhe ndryshimet e: Planit Komunal për Zhvillim (PKZH); Planit për Zhvillim Urban (PZHU) dhe Planit Rregullativ Urban (PRRU). Roli i Kuvendit Komunal në qeverisjen lokale e bën atë shtyllë të rëndësishme të SMI. Për shkak të kufizimeve në llogaridhënien horizontale në rastin e Kuvendit Komunal, përgjegjësia e tij ndaj SMI-së komunale është aktualisht e kufizuar në sigurimin e zotimit të komunës për zbatimin përkatës, gjersa Komuna, si organ ekzekutiv, është përgjegjëse për të siguruar përshtatshmëri të SMI dhe për zbatimin dhe respektimin e saj.

- 2.1.1. T'i propozojë Kuvendit Komunal miratimin e Kodit të Etikës/Kodit të Sjelljes/Rregullave të Integritetit të cilat trajtojnë *deputetët e Kuvendit Komunal*. Në përputhje me praktikatat e mira ndërkombëtare, kjo do të përçojë një mesazh të fortë për sa i përket zotimeve të integritetit të këshilltarëve komunalë.
- 2.1.2. Të inkurajohet pjesëmarrja e deputetëve të Kuvendit Komunal në ngjarjet e ndërgjegjësimit/marrëdhënieve me publikun lidhur me integritetin, si dhe rishikimin e menaxhimit të integritetit. Të mbështeten për të demonstruar leadershipin e tyre në parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit ashtu siç zbatohet në fushat e tyre të përgjegjësisë.

## Kabineti i Kryetares së Komunës

**Arsyeshmëria:** Është veçanërisht e rëndësishme që menaxhmenti i lartë ta mbajë rolin udhëheqës në arritjen e pajtueshmërisë dhe koherencës në pjesët e Komunës për të cilat kanë përgjegjësi. Çështjet e koordinimit janë vendimtare që Kabineti ta kuptojë rolin e tij. Ato janë gjithashtu lartë në agjendën e reformave. Hapat për të koordinuar politikëbërjen dhe ofrimin e shërbimeve të pushtetit lokal përipiqen që t'i eliminojnë situatat në të cilat politikat e ndryshme minojnë njëra tjetrën, përdorin më të mirë burimet, krijojnë dhe ofrojnë qasje të plotë, jo të fragmentuar për qytetarët në shërbime. Përbushja e objektivit të përbashkët dhe reagimi i integruar i menaxhimit ndaj çështjes së integritetit është një dimension i shtuar vendimtar. Vlerësimi i rrezikut i realizuar në Komunën e Gjakovës ka identifikuar rastet e humbjes së kontrollit, ndikimit dhe informatave, për të cilat ende kërkohet llogari, si problematike. Kjo ka rezultuar në përpjekje për të fuqizuar kapacitetet e komunikimit dhe kontrollin e Kabinetit të Kryetares së Komunës. Ekziston një përpjekje gjithnjë e më e madhe për koordinim dhe koherencë në politikat komunale përmes krijimit të një platforme-sistemi të politikave të përbashkëta që mund të korri efikasitete. Kjo do të gjenerojë një kapacitet më të fortë kolektiv në vend se mbi të gjitha të mendohet për interesin e secilës njësi të vetme.

- 2.1.3. Të krijohet /mirëmbahet një sistem koherent dhe i strukturuar i koordinimit të brendshëm përgjatë shtyllave si në vijim: (1) koordinim vertikal; (2) koordinim horizontal ndërmjet njësive të ndryshme; (3) koordinim me qeverinë qendrore; (4) koordinim me organizatat supra-nacionale dhe multinacionale; (5) koordinim me OJQ-të dhe organizatat e interesit të sektorit privat.
- 2.1.4. Të krijohet/mirëmbahet/përmirësohet vazhdimisht një sistem digjital i komunikimit të brendshëm duke përdorur infrastrukturën e TI për të mundësuar shkëmbim më efikas të të dhënave dhe të komunikimit tek të gjitha njësitë.
- 2.1.5. Të rritet llogaridhënia dhe efikasiteti i shërbimit, të zbatohet një sistem elektronik menaxhimit të dokumenteve. Ky sistem do të lejojë ndarjen elektronike dhe monitorimin e dokumenteve; përpunimin elektronik të peticioneve, krijimin e një interfejsi elektronik për të siguruar informacione që kanë të bëjnë me peticionet e lidhura me statusin e dosjeve.
- 2.1.6. Të rritet transparenca dhe llogaridhënia për klientët, të sigurohet që komunikimi me klientët – kërkesat e drejtpërdrejta, emailat, korrespondenca me letra të pranuar dhe përgjigjet në to menaxhohen nga një Modul Softuerik adekuat i Kontrollit të Dokumenteve. Të konsiderohet aplikimi i një ditari për t'i regjistruar të gjitha ankesat për qëllime të veprimeve përcjellëse; emërimi i një zyrtari të lartë të veçantë që do të ngarkohet me monitorimin e ankesave dhe zgjidhjen e tyre. Të sigurohet që rezultatet janë komunikuar në kohë tek

ankuesit. Të sigurohen analiza periodike (gjashtë mujore dhe vjetore) të sinjaleve, sugjerimeve dhe ankesave, që kanë të bëjnë me cilësinë e shërbimeve dhe respektimin e standardeve për shërbimet e ofruara. Qendra e Informacionit do të jetë në përputhje me Modulën e Softuerit të Kontrollit të Dokumenteve në pjesën që lidhet me peticionet e klientëve.

### **Sistemi i menaxhimit financiar. Regjistrimi dhe menaxhimi i aseteve**

**Arsyeshmëria:** Kontrollët financiarë janë proceset e menaxhimit që ndihmojnë Komunën të sigurojë që financat e saj janë duke u menaxhuar si duhet. Kontrollët e përzgjedhura operacionale që mund të ulin rreziqet integritetit në Komunë pritet të mbulojnë, si për shembull: aplikimin e vazhdueshëm të ndarjes së detyrave në fusha të caktuara të rrezikut të lartë; nivele të duhura të autoritetit për miratimin e pagesave; sigurimi që caktimi i pranuesit të pagesave dhe puna ose shërbimet e kryera janë miratuar duke përdorur mekanizma specifikë të miratimit; të kërkohen së paku dy nënshkrime për miratimet e pagesës; të kërkohet dokumentacion përkatës mbështetës që do të bashkëngjitet në miratimet e pagesave; të kufizohet përdorimi i parave të gatshme; të sigurohet që kategorizimet dhe përshkrimet e pagesave në llogari janë të sakta dhe të qarta; të realizohet rishikimi periodik të menaxhimit të transaksioneve të rëndësishme financiare; të realizohet auditimi financiar periodik. Përveç rregulloreve të aplikueshme, Komuna do të përpiqet që, në mënyrë të vazhdueshme, të integrojë dhe zbatojë kontrollët e mësipërme në procedurat dhe praktikatat e saj të brendshme të menaxhimit financiar

### **Masat:**

- 2.1.7. Të zhvillohen *procedura gjithëpërfshirëse të brendshme për menaxhimin e buxhetit*
- 2.1.8. Të krijohet një sistem i besueshëm/mekanizëm adekuat për gjurmimin e shpenzimeve buxhetore në intervale të planifikuar të duhura (p.sh. në baza mujore) për të lejuar përlllogaritje më të mirë të dinamikës së zbatimit të buxhetit
- 2.1.9. Të ndërtohet/fuqizohen kapacitetet profesionale adekuate të stafit përmes trajnimeve të synuara dhe aktiviteteve të ndërgjegjësimit
- 2.1.10. Të rritet *mbikëqyrja e jashtme* mbi realizimin e buxhetit përmes themelimit të një komisioni i cili do të përbëhet nga përfaqësues të pushtetit lokal dhe vëzhguesve të pavarur nga OJQ-të, për ta monitoruar realizimin e buxhetit në baza të rregullta, p.sh. çdo semestër. Kjo do ta hapë procesin dhe do të sigurojë që procesi është duke u realizuar në mënyrë efektive. Të organizohen

debate/forume publike për t'i informuar qytetarët lidhur me realizimin e buxhetit, për t'i publikuar raportet e realizimit të buxhetit

- 2.1.11. Të monitorohen dhe përputhen të gjitha kreditë në baza mujore
- 2.1.12. Të publikohet lista e debitorëve për të siguruar stimulim shtesë që qytetarët t'i përmbushin obligimet e tyre.
- 2.1.13. Të parandalohet përvetësimi i paligjshëm i aseteve, të kompletohet, mirëmbahet dhe përditësohet rregullisht regjistri i aseteve dhe i njëjti të monitorohet në baza mujore.
- 2.1.14. Të lejohen auditime të rregullta dhe ad-hok në regjistrimin e pronës. Të rritet kontrolli mbi regjistrimin e pronave duke lejuar kontrolle ad hok mbi të njëjtën pikë për të verifikuar nëse regjistrimi është i plotë, i saktë dhe i drejtë.
- 2.1.15. Si masë mbrojtëse ndaj keqpërdorimit të automjeteve për përfitim personal, të aplikohen dhe monitorohen regjistrat e automjeteve, GPS dhe ditarët e evidencës. Të aplikohen auditime ad hok për fuqizimin e respektimit të rregullave të përcaktuar dhe të parandalohet keqpërdorimi.

## Prokurimi publik

**Arsyeshmëria:** Prokurimi publik është veprimtari e rëndësishme ekonomike e komunës që ka ndikim të madh në mënyrën se si shpenzohen paratë publike. Nga të gjitha aktivitetet e pushtetit lokal, prokurimi publik është një nga aspektet më të cenusshëm ndaj korrupsionit meqë bashkëveprimi i drejtpërdrejtë privat-publik paraqet mundësi fitimprurëse për fitim të paligjshëm. Interesat financiare në fjalë, dhe ndërveprimi i ngushtë mes aktorëve publikë dhe privatë, e bëjnë prokurimin publik fushë madhore të rrezikut. Forcimi i kontrolleve operationale të integritetit në prokurimet publike bëhet element jetik për menaxhimin e integritetit.

### Masat:

- 2.1.16. Të sigurohet *transparencë optimale* nëpër tërë procesin e prokurimit publik, disponueshmëri maksimale e informatave përkatëse të prokurimit, që janë të qasshme dhe lehtësisht të përdorshme: d.m.th. procedurat, kriteret e përzgjedhjes dhe vlerësimit; informata për ngjarjet që kanë ndodhur pas dhënies së kontratës, modifikimet e kontratës. Për ta mundur një qasje të strukturuar, të aplikohen Pragjet Minimale të Transparencës në Prokurimin Publik në Komunën e Gjakovës dhe të monitorohet zbatimi i tyre.
- 2.1.17. Të fuqizohen kapacitetet për menaxhimin e prokurimit publik përmes *përdorimit efektiv të të gjitha mundësive* për të rritur *njohurinë, aftësitë dhe*



*integritetin e zyrtarëve të prokurimit publik (pra, aktivitete të KIPA dhe të bazuara në projekt).*

- 2.1.18. Të ngrihen kapacitetet për përgatitjen e *specifikimeve të tenderit* dhe kontrollet operacionale të integritetit: të ndërtohet/forcohet kapaciteti i stafit për përgatitjen e specifikimeve të tenderit. Të konsiderohet një qasje e strukturuar për t'i zgjeruar/forcuar kapacitetet për përgatitjen e specifikimeve dhe dokumentacionit të tenderit dhe t'i kompensojnë mangësitë ekzistuese të kapaciteteve përmes përfshirjes së stafit të brendshëm (p.sh. nga njësitë e tjera në fushat përkatëse), si dhe ekspertë të jashtëm (nga industria/sectorët përkatës , OJQ-të, etj.). Të krijohet një Komision (Organ reference) në kuadër të Njësisë për kërkesa si organ i përhershëm i mbështetjes i ngarkuar për t'i verifikuar specifikimet e përgatitura. Të krijohet dhe mirëmbahet një bazë elektronike e specifikimeve për të lehtësuar përgatitjen e tenderëve të ardhshëm.
- 2.1.19. Të zhvillohen *udhëzimet e brendshme* për të krijuar një *zinxhir të qartë të përgjegjësisë* së bashku me mekanizmat efektivë të kontrollit duke përcaktuar autoritetin për miratim, bazuar në *ndarjen e duhur të detyrave*, si dhe detyrimet për *raportim të brendshëm*. Të sigurohet që funksionet e mëposhtme trajtohen nga punonjësit e ndryshëm: rekomandimi i dhënies, lëshimi i urdhrave të blerjes, certifikimi i pranimit të mallrave dhe shërbimeve, si dhe verifikimi i pagesave
- 2.1.20. Kur është e mundur, të aplikohet dhe përforcohet praktika e rotacionit të stafit në prokurimet publike dhe njësi kontraktuese për të shmangur marrëdhëniet e mundshme korruptuese.
- 2.1.21. Të lejohet aplikimi i njëtrajtshëm i rregulloreve në procesin e prokurimit publik. Të kërkohet që të gjithë anëtarët e Komisionit të Tenderit të nënshkruajnë formularin e Deklaratës së Interesit.
- 2.1.22. Të kufizohen mundësitë për komunikim me ofertuesit përmes përcaktimit të protokollit të qartë për komunikime me ofertuesit dhe krijimit të pikave të qarta të kontaktit për ofertuesit. Vetëm një numër i vogël i zyrtarëve të lejohet të komunikojë drejtpërsëdrejti me ofertuesin.
- 2.1.23. Të inkurajohen kompanitë që kanë veprimtari ekonomike me Komunën që të certifikohen se kanë vepruar në përputhje me angazhimet e integritetit të komunës dhe të kërkohet që ata të nënshkruajnë deklarata të tilla të zotimit krahas kontratës së lidhur.
- 2.1.24. Të krijohet një sistem për filtrimin e kontraktuesve dhe përfituesve potencialë, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara për vlerësimin e kontraktuesve. Në mungesë të një sistemi kombëtar për kontrollin e kredencialeve, të

miratohet dhe mirëmbahet një bazë e të dhënave/listë e zezë e furnizuesve/nënkontraktuesve që nuk kanë arritur t'iu përmbahen standardeve të integritetit të brendshëm të komunës, si mjet për t'i udhëzuar vendimet e mundshme të përjashtimit.

- 2.1.25. Të fuqizohen OSHC-të, mediat dhe publiku i përgjithshëm në analizimin e thellë të prokurimeve publike komunale, d.m.th. përmes shpalosjes së informatave publike të titujve të kontratave të mëdha, duke përfshirë përfaqësues nga OJQ-të dhe publikun e përgjithshëm në monitorimin e prokurimeve me vlerë të lartë apo komplekse që ngërthejnë rreziqe të mëdha për keqmenaxhim dhe korrupsion; të aplikohet kërkesa që komisionet e përzgjedhjes që në të vërtetë përzgjedhin fituesit e tenderëve, të përfaqësohen nga pjesëtare të pushtetit lokal dhe vëzhgues të pavarur të OJQ-ve.
- 2.1.26. Të forcohen procedurat/praktikat për *kontrollet e cilësisë mbi zbatimin e kontratave* përmes intensifikimit të kontrolleve ad hok, duke përdorur komisione, sipas nevojës, dhe kërkesa më të rrepta për dokumentimin e kontrolleve të cilësisë dhe pranimit të rezultateve.
- 2.1.27. Të zhvillohen tregues të performancës së prokurimit për të monitoruar dhe përmirësuar performancën e prokurimit në kohë: d.m.th. numrin e ankesave, kohën mes hapjes së tenderit dhe dhënies së kontratës, numrin e ndryshimeve të kontratës, rritjen e çmimeve, etj.
- 2.1.28. Të forcohen mekanizmat e llogaridhënies dhe kontrollit (p.sh. kontrollit dhe auditimit të brendshëm, si dhe sistemet e shqyrtimit), në varësi të vlerës, kompleksitetit dhe ndjeshmërisë së prokurimit publik. Të caktohen auditime pas dhënies së kontratave të prokurimit për tenderët mbi një vlerë të caktuar për të shqyrtuar zbatimin e standardeve të caktuara procedurale. Për prokurimet me vlera të larta apo të mëdha, të kërkohet vërtetimi i pavarur (p.sh. përmes auditorit të ndershmërinë ose përfshirjes së palëve të jashtme). Të kryhen kontrolle të rastit ose auditime të procedurave jo-konkurrese.

## Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore

**Arsyeshmëria:** Proceset e MBNJ dhe ZHBNJ kanë tendencë të kenë në fokus një ndjeshmëri të jashtëzakonshme për sa i përket integritetit. Çdo vlerësim i rrezikut do të fillojë me kontrollet operationale të MBNJ dhe janë të pakta masat që mund të tërheqin aq bashkëpronësi sa ato që kanë të bëjnë me proceset e MBNJ. Mbujoja më e fort në mbrojtjen e integritetit i takon kontrolleve efektive operationale të MBNJ. Prandaj, ato përkufizohen si

me rëndësi të jashtëzakonshme në Komunën e Gjakovës, e cila konsideron se pasuria më e madhe e saj janë punonjësit e saj.

- 2.1.29. Të avancohen më tutje *proceset e rekrutimit dhe përzgjedhjes* përmes zhvillimit të një *procedure të brendshme* të qartë dhe gjithëpërfshirëse për rekrutimin dhe përzgjedhjen dhe duke siguruar se rekrutimi dhe përzgjedhja i referohen kritereve të qarta dhe transparente të përzgjedhjes për të parandaluar favorizimet dhe nepotizmin. Nëse është e mundur të konsiderohet përdorimi i një *sistemi elektronik për rekrutimin* që do të siguronte gjurmë të qarta të auditimit dhe do të minimizonte mundësitë për abuzim. Për t'i kompensuar mangësitë lidhur me personelin e kualifikuar, të krijohet dhe mirëmbahet një *datbazë e kandidatëve* për të lehtësuar kërkimin e stafit. Të përkufizohen *standartet minimale të transparencës* dhe të monitorohet zbatimi i tyre. Të përcaktohen rregulla të qarta për *funksionimin e komisioneve përzgjedhëse* (deklaratat e KI të nënshkruara nga të gjithë anëtarët, intervista me kandidatë të mundshëm që do të mbahen nga menaxherët e linjës dhe BNJ, çdo anëtar të marrë shënime, të cilat do t'i dorëzohen BNJ dhe futen në dosjen e kandidatëve për punë); kontrole ad hok të aktiviteteve të komisioneve të rekrutimit, duke siguruar gjurmë të auditimit dhe mekanizma efektivë të ankesave, regjistrim të aplikacioneve dhe letrave të rekomandimit. Shënimet nga intervistat nga secili anëtar i komisionit përzgjedhës të mbahen në dosjen e rekrutimit. Sipas nevojës, të merret në konsideratë mundësia për të përfshirë një vëzhgues të pavarur, jashtë komunës, në panelin përzgjedhës.
- 2.1.30. Të verifikohen kualifikimet e kandidatëve për punë, si pjesë e aplikimit të tyre për pozitë para emërimit. Të informohen të gjithë kandidatët, në mënyrë të qartë, se kualifikimet e rrejtshme çojnë në shkarkimin dhe/ose ndjekje penale për vepra përkatëse. Të sigurohet se të gjithë kandidatët nënshkruajnë një certifikatë përmes së cilës deklarojnë që kualifikimet që i pohojnë janë të vërteta dhe se pranojnë që çdo kualifikim i rrejtshëm mund të çojë në shkarkimin e tyre. të përfshihet një dispozitë që i lejon Komunës ta ndërpresë marrëdhënien e punës të një kandidati i cili ka paraqitur kualifikime të rrejtshme.
- 2.1.31. Të sigurohet që përshkrimet e vendeve të punës përkufizojnë qartas dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse përgjegjësit individuale në pajtim me rregulloret përkatëse për organizim të brendshëm dhe sistematizim të punëve; të sigurohet që ato bëhen të njohura për të gjithë stafin. Rishikim i detyrave dhe përgjegjësive të të gjitha pozitave për të siguruar kontroll adekuat të përgjegjësisë, profesionalizmit dhe integritetit.

- 2.1.32. Në procese kyçe operacionale, të aplikohet një sistem ku stafi i deklaron, ndërsa komuna mban shënime me shkrim të konflikteve aktuale apo të mundshme të interesit. Kjo ndihmon në identifikimin e situatave ku stafi , përmes lidhjeve familjare apo të tjera, mund të mos parandalojë apo raportojë shkeljet e integritetit.
- 2.1.33. Të rriten kontrollet *mbi menaxhimin e orarit të punës*: të merret parasysh përdorimi i një sistemi të regjistrimit të orarit të punës, veprimet e atypëratyshme të kontrollit; sistemi i ankesave, etj.
- 2.1.34. Të rritet transparenca e *menaxhimit të udhëtimeve zyrtare*; të sigurohet se të gjitha udhëtimet zyrtare janë bërë sipas kritereve të përkufizuara qartas, të jenë publike dhe në pajtimit me kushtet e përcaktuara.
- 2.1.35. Të përditësohet *sistemi aktual i shpërblimeve* për t'u marrë parasysh mundësitë që të tërhiqen dhe mbahen pjesëtarët e kualifikuar të stafit. Të konsiderohen mundësitë për të ofruar stimulime shtesë për ta motivuar stafin në pozita me rrezik të lartë. Të mbahet një nivel i duhur i transparencës së sistemit operacional. Rishikim i politikave të masave stimuluese që kanë ndikim në motivimin dhe demotivimin e punonjësve. Përcaktimi i Treguesve të Performancës sipas procedurave të sofistikuar evropiane
- 2.1.36. Të përditësohet *sistemi aktual i vlerësimit të stafit* në pajtim me rregulloret kombëtare në fuqi. Për ta mbajtur integritetin, të konsiderohen mundësitë e aplikimit të kritereve të njëtrajtshme dhe gjithëpërfshirëse për largimin/minimizimin e nivelit potencial të subjektivitetit të atyre të përfshirë; të maksimizohet transparenca, të garantohet gjurma e auditimit dhe të sigurohen stimulime të nevojshme dhe ndërtim i besimit; të sigurohen politika të ngritjes në detyrë në baza meritore.
- 2.1.37. Aty ku është e mundur, të aplikohet praktika e *matjes së kënaqshmërisë së stafit* me punën dhe mjedisin e integritetit si “sistem i paralajmërimit të hershëm” për zbulimin e çështjeve dhe trendeve.
- 2.1.38. Të përmirësohet *sistemi aktual i menaxhimit të trajnimeve* për ta rritur efektivitetin, efikasitetin dhe transparencën e saj. Për këtë qëllim, të lidhet procesi i Analizës së Nevojave për Trajnime (ANT), me ofrimin e trajnimeve dhe vlerësimin e trajnimeve. ANT do të përcaktojë nevojat aktuale të trajnimit dhe do t'i lidhë ato me mundësitë më të mira të trajnimit (të përdoret një metodologji e strukturuar, të kryhen vizita të rastit për të siguruar se pjesëmarrja në trajnime është përcaktuar në bazë të nevojave dhe meritave dhe jo në baza arbitrare / subjektive, të shënohen rezultatet). Mbajtja e trajnimit mund të avancohet përmes forcimit të fokusit praktik të trajnimit dhe përshtatjes së tij sipas nevojave të vërteta. Përmirësimi i vlerësimit të trajnimit

do të thotë që të shkojë përtej matjes së perceptimeve/reagimeve të trajnimit, dhe matjes së transferimit në vend të punës dhe ndikimit organizativ. Rezultatet të komunikohen dhe përdoren për të korrigjuar joefikasitetet e lidhura.

- 2.1.39. Të sigurohen *trajnime adekuate profesionale të stafit që punon në Departamentin e Burimeve Njerëzore*. Të përdoren burime të jashtme në dispozicion (d.m.th. IKAP, trajnime nga projekte) për t'i zgjeruar mundësitë.
- 2.1.40. Menaxhmentit të lartë dhe të mesëm t'u sigurohen trajnime adekuate në *planifikimin integritetit dhe menaxhimin e rrezikut* për të siguruar që procesi i menaxhimit të integritetit në Komunë ka burime të mjaftueshme.
- 2.1.41. Të konsiderohen mundësitë për futjen e ndryshimeve/plotësimeve në rregulloret e aplikueshme ligjore që kanë të bëjnë me rekrutimin dhe përzgjedhjen, vlerësimin dhe zhvillimin e karrierës, përmes pjesëmarrjes në grupe të ekspertëve, ofrimit të komente/propozimeve.

## Auditimi i brendshëm

**Arsyeshmëria:** Qëllimi i funksionit të auditimit është që të ofrojë siguri të arsyeshme për menaxhmentin e lartë se proceset janë duke operuar në mënyrë efektive, duke përfshirë zbatimin e sistemit të menaxhimit të integritetit. Ato ndihmojnë që të zbulohen shkeljet e integritetit dhe veprojnë si parandalim të zyrtarëve potencialisht korruptues (meqë ata do të jenë në dijeni se projekti apo departamenti i tyre do të mund të përzgjidhet për auditim). Rritja e cilësisë së funksionit të auditimit në Komunën e Gjakovës, në mesin e masave të tjera, do të mbulojë një riorganizim të plotë; futjen e sistemit të planifikimit të auditimit dhe inspektimit të bazuar në rreziqe (p.sh. vlerësimi i auditimit të mjedisit të brendshëm; vlerësimi i rrezikut të sistemit të auditimit (faktorët e kritereve të rrezikut dhe metodat e vlerësimit të kritereve të rrezikut; prioritizimi i sistemit të auditimit; strategjia e auditimit të brendshëm, etj.); staf adekuat dhe zhvillim profesional të stafit të përfshirë; procedura të rrepta të monitorimit dhe kontrole specifike të integritetit.

- 2.1.1. Të *rishikohet rrjedha e procesit* në kuadër të njësisë së auditimit për t'i identifikuar mundësitë për përmirësim të efektivitetit, efikasitetit dhe transparencës. Nëse është e nevojshme dhe e realizueshme, të ristrukturohet funksionimi i njësisë së auditimit.
- 2.1.2. Të *rishikohet procedura ekzistues operative*, për të përcaktuar qartë përmes PSO, që mbulon të gjitha fazat kryesore, kërkesat për dokumentacion dhe raportim, ndarjen e përgjegjësive përkatëse. Të trajtohet menaxhimi i rrezikut, veprimet specifike të kontrollit, planifikimi i auditimit të brendshëm, resurset e auditimit

- të brendshëm, vlerësimi i brendshëm i performancës së auditimit dhe sigurimit të cilësisë. Të komunikohen procedurat tek stafi përkatës. Të sigurohet planifikim efektiv i auditimit sipas rezultateve të vlerësimit të rrezikut. Të monitorohet zbatimi i planit të auditimit dhe të parashikohen masa të menjëhershme korrigjuese në rast të dështimeve
- 2.1.3. Të rishikohet Organogrami dhe të përputhen *përshkrimet e vendeve të punës* të stafit të auditimit me procedurat e rishikuara operacionale.
- 2.1.4. Të fuqizohen *kapacitetet e njësive dhe të rritet profesionalizmi i ekipit të auditimit*. Për këtë qëllim, të krijohet dhe zbatohet një program i synuar trajnimi për auditorët dhe/ose të merren parasysht mundësitë e trajnimit të ofruara nga IKAP dhe ofruesit e tjerë të trajnimeve të specializuara. Fushat: kryerja e auditimeve specifike (p.sh. auditime të mashtrimit, auditime të TI-së, auditime të cilësisë të menaxhimit), zbatimi i procedurave të auditimit (mostrimi, intervistat, mjaftueshmëria e dëshmive, etj.).
- 2.1.5. Të rishikohen mundësitë për *rritjen e stimulimeve të punës për auditorët* në kuadër të sistemi aktual të shpërblimeve, d.m.th. të punohet në koeficientin e rrezikshmërisë.
- 2.1.6. Kur është e mundur, të zbatohen *kontrolle operative të integritetit*: parimi i rotacionit dhe katër syve për të shmangur paraqitjen dhe forcimin e marrëdhënieve korruptuese; Të sigurohet aplikim efikas i konflikteve të interesit në proceset e auditimit për të siguruar që stafi i përzgjedhur për t'i kryer këto funksione është i lirë nga çdo dyshim që ka të bëjë me integritetin. Për këtë qëllim, të përcaktohen kërkesa të qarta, që kërkojnë dorëzimin e deklaratës së KI dhe të kryhen kontrolle të rastit mbi zbatimin efektiv të tyre.
- 2.1.7. Të përmirësohet *sistemi i komunikimit* (rrjedha e informatave) ndërmjet njësisë së auditimit të brendshëm dhe organeve të tjera komunale. Për këtë qëllim, duhet të aplikohet një sistem i cilësisë së informatave në të gjitha proceset e punës.
- 2.1.8. Të rritet shpeshtësia dhe shumëllojshmëria e auditimeve; *të rritet përdorimi i auditimeve të rastit* (të papritura/të paplanifikuara) për t'i përcjellë auditimet e fundit dhe verifikuar gjetjet/procedurat e përdoruar.
- 2.1.9. Të rritet *kontrolli mbi zbatimin e gjetjeve/rekomandimeve të auditimit*. Për këtë qëllim, të merret parasysht krijimi i një ueb-monitorimi si një sistem elektronik që monitoron aktivitetet përcjellëse të auditimit dhe inspektimit të brendshëm për të siguruar që të gjitha rastet e shkeljeve të dyshuara janë zgjidhur në mënyrë të kënaqshme. Sistemi do të trajtojë edhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe atij të jashtëm dhe do ta regjistrojë progresin e arritur në

zbatimin e tyre dhe do të funksionojë si një instrument i vetëm për menaxherët publikë në monitorimin dhe vlerësimin e veprimeve të kontrollit të brendshëm.

- 2.1.10. Në baza periodike të vlerësohet efektiviteti i sistemit të auditimit të brendshëm bazuar në procedurën e zhvilluar dhe treguesit përkatës. Të lejohet publikimi i rezultateve për ta fuqizuar fokusin parandalues.

## 2.2. Përmirësimi i rezistencës organizative ndaj shkeljeve të integritetit në proceset operacionale me rrezik të lartë përmes kontrolleve të optimizuara të integritetit

**Arsyeshmëria:** Komuna do të përdorë kontrolle operacionale për të menaxhuar rreziqet kryesore të identifikuar të integritetit, për të siguruar përputhshmëri me kërkesat ligjore, dhe për të shmangur ose minimizuar rreziqet e integritetit. Gjatë identifikimit të nevojave për kontrolle operative, Komuna merr në konsideratë të gjitha operacionet e saj, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me funksionet e menaxhimit (p.sh. blerjet, menaxhimi financiar, etj.), si dhe të gjitha këto operacionet kryesore të përditshme operacionale. Vlerësimi i ndërmarrë i rrezikut vë në pah rreziqe të mëdha të integritetit në kontekst të funksioneve kryesore të Komunës, në fushat vijuese: planifikimi hapësinor; zbatimi i rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit; banimi publik; zhvillimi ekonomik lokal; menaxhimi i hapësirës; licencimi i shërbimeve dhe objekteve publike, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitetet kulturore, ushqimin, akomodimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportin publik lokal dhe taksitë; shëndetin publik; ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugët lokale, transportin lokal dhe skemat e ngrohjes lokale.

Në mesin e kompetencave të deleguara të komunës, më të ndjeshmet ndaj shkeljeve të integritetit (të prira ndaj korrupsionit) janë vlerësuar të jenë të dhënat kadastrale; regjistrimi i votuesve; shpërndarja e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve); dhe mbrojtja e pyjeve në territorin e komunës. Duke pasur përballë sfidat e mësipërme, komuna ka identifikuar prioritetet afatshkurtra dhe afatgjata dhe kontrollet e strukturuar operacionale në forma të ndryshme, siç janë procedurat, udhëzimet e punës, kontrollet fizike, përdorimi i stafit të trajnuar ose ndonjë kombinim i këtyre. Zgjedhja e metodave të veçanta të kontrollit varet nga një numër faktorësh, siç janë aftësitë dhe përvoja e njerëzve që kryejnë veprimet dhe kompleksiteti dhe rëndësia e integritetit të vetë veprimit.

### **Të përgjithshme**

- 2.2.1. Nëse është e mundur, të rritet numri i shërbimeve publike elektronike. Të aplikohen teknologji të informacionit për ta rritur transparencën, cilësinë dhe shpejtësinë e shërbimeve publike.
- 2.2.2. Aty ku është e mundur, të krijohet/rritet niveli i shërbimeve të ofruara për qytetarët në formë të *one stop shop*;

### **Shërbimet publike**

- 2.2.3. Të rishikohet rrjedha e procesit në sektorin e shërbimeve publike për t'i identifikuar mundësitë për përmirësimin e efektivitetit, efikasitetit dhe transparencës. Nëse është e nevojshme dhe e realizueshme, të ristrukturohet funksionimi i njësisë së shërbimeve publike.
- 2.2.4. Të rishikohen procedurat ekzistuese operative, për t'u përcaktuar me PSO të të qarta. Të zhvillohen dhe zbatohen *planet e punës për t'i përcaktuar qartas procedurat për lëshimin e lejeve për shërbimet përkatëse* dhe për zbatimin e tyre të plotë dhe të kënaqshëm
- 2.2.5. Të përputhen *përshkrimet e vendeve të punës* të stafit të përfshirë me procedurat e rishikuara operative.
- 2.2.6. Të institucionalizohet dhe mirëmbahet *një sistem i strukturuar i raportimit të rregullt periodik* për zbatimin e detyrave dhe projekteve në bazë të planeve përkatëse të punës. Të rritet numri dhe cilësia e trajnimeve për të siguruar që mangësitë e trajnimeve janë mbuluar mirë.
- 2.2.7. Të analizohen mundësitë që të optimizohet *hapësira* ekzistuese në mënyrë që të arrihet një ndarje më efikase e zyrave
- 2.2.8. Të *minimizohen mundësitë e kontakteve të drejtpërdrejta* të palëve të interesuara me zyrtarët komunalë dhe të *zbatohet ndarja e detyrave* (vendimi të hartohet nga zyrtari profesional, ndërsa pagesa dhe dorëzimi i vendimit bëhet nga një zyrtar tjetër)
- 2.2.9. Të rritet planifikimi duke mundësuar vendosjen e *prioriteteve, në bazë të kritereve dhe procedurave të qarta*
- 2.2.10. Të mbështetet zhvillimi i një *Sistemi Kombëtar të Monitorimit të Referencave të Ofruesve të Shërbimeve* ashtu që të ketë udhëzime efektive për vendime për përjashtim
- 2.2.11. Të krijohet një organ për mbikëqyrjen e projekteve para se të hyjnë në fazën e prokurimit



- 2.2.12. Të sigurohet që përshkrimet teknike për projekte të hartohen qartas dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse në përputhje me aktet dhe standardet e aplikueshme ligjore. Të rritet profesionalizmi i stafit të përfshirë në hartimin e specifikimeve teknike dhe të sigurohet një monitorim i vazhdueshëm dhe kontroll i cilësisë së përshkrimeve të hartuara teknike
- 2.2.13. Të rriten kontrollet dhe inspektimi i aplikimit të vendimeve për të vlerësuar përputhshmërinë me rregulloret
- 2.2.14. Të raportohet lidhur me mospërputhjet në sistemin ligjor në fuqi në mënyrë që të nisen ndryshimet e plotësimet e nevojshme.

### **Kadastr**

- 2.2.15. Të rishikohet *organogrami* i njësisë së kadastrit në mënyrë që të përcaktohet qartë gjurma e llogaridhënies, si dhe detyrimet e qarta të raportimit. Të riorganizohet procesi i rrjedhës së punës në njësinë e kadastrit me kontrolle të forta të integritetit; të sigurohet nivel i duhur i përgjithshëm i llogaridhënies në Njësinë e Kadastrit
- 2.2.16. Të ndërmerren hapa efektivë për të siguruar *burime adekuate njerëzore në funksionin e kadastrit* me kompetenca të duhura; Të sigurohen *trajnime adekuate profesionale* për stafin në drejtorinë e kadastrit, të sigurohet se ka njohuri të parimeve/kontrolleve/rregullave të SMI; të shpërndahet informata dhe trajnime adekuate për udhëzimet e reja ose kornizat për matje kadastrale
- 2.2.17. Të sigurohet që stafi i njësisë së kadastrit udhëhiqet nga një *Kod specifik i Sjelljes* për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të veçanta të stafit
- 2.2.18. Të forcohen mekanizmat e kontrollit, duke përfshirë operacionet ad hok dhe të klientit të fshehtë
- 2.2.19. Të aplikohet dhe mirëmbahet një *sistem i realizueshëm i skanimit dhe arkivimit profesional*
- 2.2.20. Të forcohen/diversifikohen *mekanizmat e kontrollit të brendshëm, d.m.th. në zyra të pranimit-recepcion, regjistrimin dhe çregjistrim të hipotekave*
- 2.2.21. Të forcohen mekanizmat e ankesave publike dhe bilbilfryrësve
- 2.2.22. Të sigurohet pjesëmarrje, përmes opinioneve të ekspertëve apo grupeve të punës, në rishikimin/ndryshimet e dispozitave ligjore në fuqi

### **Inspektimet**

- 2.2.23. Të përmirësohet i tërë menaxhimi i funksionit të inspektimit për ta rritur efektivitetin, llogaridhënien dhe transparencën e tij dhe në këtë mënyrë të

- rritet rezistenca ndaj shkeljeve të korrupsionit dhe integritetit (p.sh. organizimi i strukturës institucionale të inspektimit, planifikimi i inspektimit, kapacitetet, njohuria dhe aftësitë e inspektorëve
- 2.2.24. Të rishikohen procedurat e brendshme për të mbuluar funksionin e inspektimit me mbulim të të gjitha fushave kryesore të inspektimit; kërkesat për dokumentim raportim; ndarja e përgjegjësive përkatëse. Të rishikohen afatet dhe të përcaktohen afatet e brendshme si standarde të PSO, në varësi të rrezikut dhe rëndësisë së inspektimeve. Të trajtohen çështjet si menaxhimi i rrezikut, veprimet e veçanta të kontrollit, planifikimi, caktimi i burimeve të inspektimit, vlerësimi i performancës së inspektimeve dhe sigurimi i cilësisë. Të komunikohen këto procedura tek të gjithë pjesëtarët e stafit.
- 2.2.25. Të ndahen burime adekuate për funksionin e inspektimit. Të sigurohet *profesionalizmi i* stafit nëpërmjet shqyrtimit të kujdesshëm të zbrazëtirave ekzistuese të kapaciteteve. Kur është e mundur, të zbatohet parimi i rotacionit dhe katër syve për të shmangur paraqitjen dhe forcimin e marrëdhënieve korruptuese; të shqyrtohen mundësitë për rritjen e stimulimeve të punës në sistemin aktual të shpërblimeve, pra koeficienti i rrezikshmërisë së punës
- 2.2.26. Të sigurohet sistematizimi vendeve të punës dhe të përditësohet *organogrami*.
- 2.2.27. Të rritet përdorimi i inspektimeve *ad hok*.
- 2.2.28. Të sigurohet *monitorimi dhe* zbatimi i duhur dhe i njëtrajtshëm i planeve të inspektimit.

### **Planifikimi hapësinor**

- 2.2.29. Të rishikohet organogrami.
- 2.2.30. Të zhvillohen procedura të brendshme/kritere të qarta të duhura që trajtojnë rreziqet kryesore të integritetit në procesin e planifikimit urban dhe rural dhe parandalojnë vendimet subjektive
- 2.2.31. Të fuqizohet sistemi i planifikimit, të institucionalizohet planifikimi afatmesëm për t'i lidhur prioritetet dhe për të parandaluar vendimet ad hok
- 2.2.32. Për vendimet me vlerë të lartë të futen kontrole specifike operacionale, d.m.th. të krijohen komisione si organe vendimtare apo organe të tjera të kontrollit.
- 2.2.33. Të fuqizohen mekanizmat e kontrollit, p.sh. kontrollet ad hok në baza të mostrave dhe pas nxjerrjes së auditimeve përcjellëse
- 2.2.34. Të rritet transparenca e planifikimit urban dhe rural.

### **Zhvillimi lokal ekonomik dhe bujqësia**

- 2.2.35. *Të rishikohet rrjedha e procesit në njësinë e bujqësisë për të analizuar se ku janë të mbingarkuara proceset dhe ku mund të thjeshtohen; të zhvillohet një procedurë adekuate e brendshme/kritere të qarta që trajtojnë rreziqet kyçe të integritetit në sektorin e bujqësisë dhe ndalojnë vendimet subjektive; të rishikohet organogrami.*
- 2.2.36. *Të fuqizohet sistemi i planifikimit, të futet planifikimi afatmesëm për t'i lidhur prioritetet dhe për të parandaluar vendimet ad hok. Të përkufizohet se cilët sektorë japin subvencione; plane afatmesme për ndarjen e mjeteve në sektorin e bujqësisë.*
- 2.2.37. *Të sigurohen trajnime adekuate të stafit.*
- 2.2.38. *Të përmirësohet sistemi i koordinimit dhe komunikimit.*
- 2.2.39. *Të propozohen ndryshime në rregulloret përkatëse përmes opinioneve të ekspertëve apo pjesëmarrjes në grupe punuese.*

### **Arsimi**

- 2.2.40. *Të rishikohen procedurat operationale për rekrutimin e stafit në sektorin e arsimit për të siguruar kontrole adekuate të integritetit, d.m.th. të përfshihen OJQ-të, palët e tjera të jashtme në komisionet intervistuese, të rritet transparenca e procesit të intervistës, të shtohet publikimi i rezultateve të përzgjedhjes.*
- 2.2.41. *Të krijohet/ mbahet një procedurë e qartë dhe e detajuar për rindërtimin urgjent të shkollave me kritere të përcaktuara qartas; të rritet transparenca e procesit të vendimmarrjes përmes publikimit më të gjerë.*
- 2.2.42. *Të zhvillohet një politikë/strategji për rekrutimin e stafit të ri në sektorin e arsimit duke konsideruar mundësitë e rritjes së stimulimeve.*
- 2.2.43. *Të kontaktohet Ministria e Arsimit për të siguruar udhëzime shtesë mbi rregulloret në fuqi në mënyrë që arrihet një kuptim dhe aplikim koherent; Udhëzimet/informacionet të bëhen të lehta dhe në dispozicion publik*
- 2.2.44. *Përmes opinioneve të ekspertëve apo pjesëmarrjes në grupe të punës të iniciohen ndryshime e plotësime në rregulloret përkatëse për të rritur njëtrajtshmërinë dhe efektivitetin.*

### **Përdorimi dhe zhvillimi i tokës**

- 2.2.45. Të zhvillohen *procedura të brendshme/kritere të qarta* të duhura që trajtojnë rreziqet kryesore të integritetit në procesin e planifikimit urban dhe rural dhe parandalojnë subjektivizmin
- 2.2.46. Të fuqizohet *sistemi i planifikimit*, të krijohet planifikim afatmesëm për të lidhur prioritetet dhe për të parandaluar vendimet ad hok
- 2.2.47. Të fuqizohen *mekanizmat e kontrollit*, p.sh. kontrollet ad hok në baza mostrash dhe pas nxjerrjes së auditimeve përcjellëse

### **Licencimi i shërbimeve dhe hapësirave lokale, përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitetet kulturore dhe të zbatimit, ushqimin, akomodimin, tregjet, shitësit ambulante (në rruqë), transportin publik lokal dhe taksitë**

- 2.2.48. Të zhvillohen *procedura të brendshme/kritere të qarta të duhura* që trajtojnë rreziqet kryesore të integritetit lidhur me proceset e licencimit dhe që parandalojnë vendime subjektive
- 2.2.49. Të fuqizohen *mekanizmat e kontrollit*, p.sh. kontrolle ad hok në baza mostrash dhe pas nxjerrjes së auditimeve përcjellëse

### **Banimi publik**

- 2.2.50. Të zhvillohet një *politikë e banimit* dhe procedura të lidhura të cilat, së paku, do të trajtojnë rrezikun kryesor të integritetit në ndarjen e shtëpive, ku banimi mund të ndahet në mënyrë të parregullt për përfituesit, p.sh. përfituesit mund të zhvendosen më lartë listës në këmbim të përfitimeve të papërshtatshme. Të rritet transparenca lidhur me listat e pritjes.
- 2.2.51. Të rishikohet *procedura për menaxhimin e kontraktuesve aktivë në rindërtimin e banesave komunale* dhe të forcohen kontrollet e integritetit: p.sh. dorëzimi dhe pagesa e kërkesave të kontraktuesve, kontrolle mbi cilësinë e punës; pagesat e kontraktuesve të ndërtimit;.

### **Drejtoria për politika ekonomike**

- 2.2.52. Rishikim i Strukturës Organizative të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik. Rishikim i çështjes së infrastrukturës, përmes së cilës mund të themelohet si sektor i veçantë përmes një vendimi të Kuvendit. Kjo do ta mundësojë Drejtorinë e ZHE

që të zbatojë politikat komunale të zhvillimit të infrastrukturës dhe t'i plotësojë pozitat profesionale në sektorin e infrastrukturës.

- 2.2.53. Rishikim i mundësisë për të përcaktuar një kornizë të duhur për ekonomi të qëndrueshme lokale.
- 2.2.54. Rishikim i mundësisë dhe kapaciteteve të stafit për hartim të politikave të zhvillimit ekonomik, si dhe propozimeve për masat e zhvillimit komunal ekonomik.
- 2.2.55. Rishikim i mundësisë për hartimin e planit global strategjik për zhvillim komunal ekonomik, në perspektivën afatshkurte dhe afatgjate.
- 2.2.56. Rishikim i hartimit të politikave vjetore të turizmit dhe propozimi i masave për të nxitur sektorin privat që t'i përmbush objektivat e politikës së zhvillimit të turizmit. Sipas Ligjit për Turizmin nr. 04-L-176, të datës 11 prill 2013, hotelet dhe agjencitë turistike do të kategorizohen në baza vullnetare, jo të obligueshme siç edhe rregullohej me ligjin e mëparshëm. Prandaj, Ligji i për Turizmin është në përputhje me Direktivën Evropiane. Kjo kërkon monitorim të këtyre bizneseve të cilat mund të kërkojnë për përparësi më të mëdha sesa që kanë të drejtë, në mënyrë që të sigurohet një nivel më i lartë i përgjegjësisë dhe transparencës.

### **Aranzhimet për siguri fizike**

- 2.1.1. Të maksimizohet mbrojtja ndaj shkeljeve të integritetit përmes *fuqizimit të kontrolleve të sigurisë fizike*, në bazë të rishikimit të hollësishëm të aranzhimeve për siguri fizike; p.sh. fokusi specifik i vihet sigurisë së infrastrukturës, aseteve dhe stafit.

**OBJEKTIVI STRATEGJIK III:**

Përmirësimi i mjedisit të jashtëm për të përforcuar dhe zgjeruar aspektet e integritetit në proceset e modernizimit dhe reformës duke përmirësuar bashkërendim me qytetarët, bizneset dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm, komunikimit të strukturuar dhe efektiv; promovimi i transparencës dhe angazhimi i palëve të interesit; shpërndarja e praktikave të mira dhe angazhimi i përbashkët

**Linjat e aktivitetit dhe masat përkatëse****3.1. Ndërtimi/fuqizimi i mekanizmave të konsultimeve dhe komunikimit me aktorët kyçë të jashtëm në agjendën e integritetit**

**Arsyeshmëria:** Veprimet e Integritetit të Komunës së Gjakovës nuk janë thjeshtë përpjekje të brendshme; ato kërkojnë angazhim të planifikuar mirë dhe proaktiv të komunikimit dhe marrëdhënie me publikun. Qytetarët dëshirojnë të dëgjojnë për përmirësime të dukshme dhe të menjëhershme. Kërkesat për udhëheqje efektive dhe të dukshme të ndryshohen në nivelin më të lartë. Për t'i arritur standardet e larta të integritetit dhe zbatuar objektivat e tij, Komuna ka nevojë për angazhim të përbashkët të aktorëve kyçë në sektor. Angazhimi kolektiv mund të forcohet me anë të proceseve proaktive dhe të strukturuar të konsultimit dhe komunikimit.

**Të mundësohet pjesëmarrja e aktorëve lokalë në proceset komunale të vendimmarrjes strategjike dhe normative, si dhe në monitorimin dhe mbikëqyrjen e politikave komunale**

- 3.1.1. Të rritet efektiviteti i konsultimeve me aktorët e jashtëm në zhvillimin e strategjive, rregulloreve dhe buxhetit komunal duke përgatitur një Politikë të përfshirjes së aktorëve kyçë në punën e komunës, duke renditur kanalet/masat e ndryshme për nxitjen e pjesëmarrjes domethënëse publike në proceset kyçe (p.sh. postimi i projekt-rregulloreve në faqen e internetit, inicimi i diskutimeve publike dhe grupeve të fokusit për planifikimin dhe monitorimin e realizimit të buxhetit të buxhetit, forume në internet për të diskutuar projekt-strategjitë dhe rregulloret, etj.) bazuar
- 3.1.2. Të sigurohen që konsultimet me aktorët përkatës që do të ndërmerren dhe dorëzimi i parashtrësive publike janë shqyrtuar me kujdes para lëshimit të dokumenteve kyçe të planifikimit strategjik dhe dokumenteve të politikave të komunës (p.sh. Strategjia e Komunës, Buxheti i komunës).

- 3.1.3. Të merret parasysh *themelimi i grupeve teknike të punës të menaxhimit të rrezikut* me pjesëmarrje të jashtme (p.sh. profesionistë, organizata profesionale, përfaqësues të shoqërisë civile) në fushat e ndjeshme të korrupsionit (p.sh. përgatitja e specifikimeve të tenderit, përzgjedhja e punonjësve në sektorin e arsimit, etj.). Të sigurohet përfshirja e strukturuar e tyre.

**Koordinimi/komunikimi me grupet kyçe të palëve të interesit**

- 3.1.4. Të fuqizohen aspektet e integritetit në *strategjinë e komunikimit të jashtëm* duke shtuar fokusin mbi integritetin për të përcjellë mesazhin e Komunës tek të gjithë aktorët e jashtëm. Të përmirësohet faqja e internetit me informata përkatëse në lidhje me politikat/masat/arritjet e përmirësimit të integritetit të Komunës. Të fuqizohet/vihet në fokus mesazhi KK tek palët e jashtme të interesit.
- 3.1.5. Të hulumtohen mundësitë për *bashkëpunim të synuar* me Asociacionin e Komunave të Kosovës, Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe komunat e tjera të Kosovës në fushën e menaxhimit të integritetit, si dhe mundësitë për të marrë ndihmë përkatëse teknike nga donatorët për ta nxitur ngritjen e kapaciteteve dhe aktivitete të tjera të integritetit. Për këtë qëllim, të krijohet një strukturë e bashkëpunimit dhe komunikimit: persona kontaktues, mekanizma të raportimit dhe monitorimit. Të merret parasysh krijimi /pjesëmarrja në rrjete të integritetit në sektorin e pushtetit lokal për të mbështetur ndarjen e informatave dhe përvojave dhe për të ndërtuar një angazhim kolektiv
- 3.1.6. Të shqyrtohen mundësitë për *përfshirje konstruktive të shoqërisë civile lokale, bizneseve dhe mediave* në aktivitetet kundër korrupsionit të udhëhequra nga komuna. Për këtë qëllim, të merret parasysh zhvillimi i *Rrjetit Lokal të Integritetit* me pjesëmarrje të OSHC-ve aktive, organizatave profesionale të biznesit, media të rëndësishme në nivel lokal (organizatë gjysmë-formale, e njohur nga administrata publike e pushtetit lokal). Rrjeti i Integritetit duhet të ribashkojë, në nivel lokal, administratën publike lokale me palët kyçe të interesit nga sektori joqeveritar dhe ai privat për të përmirësuar përpjekjet e tyre të integritetit. Ai do të jetë në shërbim të disa qëllimeve, duke vepruar si një “roje qytetare” e punës së administratës; duke siguruar informata/ekspertizë të vlefshme në çështjet e komunitetit, duke ndihmuar në fuqizimin e bashkëpronësisë në masat e vështira të reformës.

**Linja telefonike ndihmëse kundër korrupsionit**

- 3.1.7. Të sigurohet funksionimi efektiv i një *linje të sigurt telefonike kundër korrupsionit* për qytetarët dhe bizneset, për t'i siguruar Komunës një kanal të besuar për raportimin e shkeljeve të integritetit. Të garantohet siguria e përdoruesve, ofrimi në kohë i informatave për ankuesit dhe integrimi i rezultateve në sistemin e menaxhimit përmes analizës së synuar të të dhënave dhe masave përkatëse korrigjuese.

**3.2. Promovimi i transparencës si mjet thelbësor për rritjen e llogaridhënies dhe mbikëqyrjen e jashtme të Komunës**

**Arsyeshmëria:** Roli i transparencës dhe angazhimit të qytetarëve, bizneseve dhe organizatave joqeveritare në luftën kundër korrupsionit në vend është me rëndësi të jashtëzakonshme. Kjo kërkon që Komuna të sigurojë për palët e interesuara informata cilësore për t'iu mundësuar atyre që të mbikëqyrin dhe vlerësojnë vendimmarrjen dhe politikat publike. Së bashku, transparenca dhe angazhimi i palëve të interesit mund të lehtësojë: rezultate më të mira politike me kosto më të ulët; respektim më të madh të vendimeve të nxjerra, përgjegjësi të përbashkët për ofrimin e shërbimeve dhe rol të përbashkët për përmirësim të integritetit.

- 3.2.1. Periodikisht të rishikohen mundësitë për të përdorur *Qendrën e Informacionit* si një pikë kontakti për maksimizimin e transparencës në punën e komunës dhe për t'iu siguruar qytetarëve dhe bizneseve informata të mjaftueshme, të sakta, konsistente, të qasshme dhe të lehta për t'u përdorur për t'iu mundësuar përmbushjen e obligimeve të tyre. Në bazë të rezultateve, të krijohet një *Stacion të Transparencës* ku mund të vendosen fletëpalosje të ndryshme, rregulloret, urdhra, njoftime, standardet e shërbimit, doracakët/referencat/materialet ndihmëse, etj., në formatin të lehtë për përdorues.
- 3.2.2. Të krijohet një *sistem i strukturuar për përditësim të rregullt të faqes së internetit të institucionet* me informata të mjaftueshme në fusha kyçe të funksionimit të Komunës: ligjet dhe rregulloret përkatëse; Kodi i Sjelljes; Statuti i Shërbimit të Klientëve; raportet vjetore të menaxhmentit; raportet “në format që kuptohet lehtë” të buxhetit që ofrojnë pasqyra të thjeshta të operacioneve financiare; prokurimi; rekrutimi dhe konkurset; aktivitetet dhe vendimet e nxjerra nga kuvendi komunal dhe organet administrative të tij; deklarimi i pasurisë së zyrtarëve komunalë. Të publikohen informatat përkatëse në lidhje



me politikat/masat/arritjet e përmirësimit të integritetit të Komunës, pra Deklarata e Integritetit, Plani i Integritetit dhe raportet për zbatimin e tyre.

- 3.2.3. Nëse është e nevojshme, të ofrohen trajnime të shkathtësive të TI-së të nevojshme për mbajtjen e transparencës në format të lehtë për përdorim.
- 3.2.4. Në pajtim me rregulloret kombëtare, të zhvillohet dhe zbatohet një procedurë e qartë dhe e hollësishme për procedimin e aplikacioneve për qasje në informata publike; formularët, vendet për ofrim të informatave publike dhe kostot e lidhura. Të sigurohet që punonjësit janë të trajnuar mirë mbi rregulloret përkatëse ligjore dhe procedurat e miratuara. Të ofrohet monitorim adekuat dhe profesional i zbatimit të Ligjit për qasje të lirë në informata nga komuna. Të merren masa të menjëhershme korigjuese në rast të raportimit/identifikimit të mangësive.

PLANI I VEPRIMIT						
Objektivat strategjike						
Veprimi/masat	Njësia përgjegjëse	Njësia koordinuese/ palët partnere të interesit	Afati për zbatim	Treguesit e suksesit	Kosto financiare dhe burimi i financimit	
Veprimet, masat për të mbështetur realizimin e objektivave	Komuna e Gjakovës përgjegjëse për zbatimin e masave specifike	Njësiti për të koordinuar zbatimin dhe institucionet/ose organizatat partnere	Koha e pritshme për të përfunduar zbatimin e veprimit specifik	Treguesit që shërbejnë për të verifikuar zbatimin e veprimit	Paraqet buxhetin që nevojitet për ta zbatuar veprimin relevant nga buxheti i Republikës së Kosovës ose donatorë të ndryshëm	

<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 1</b>						
<i>Forcimi i rezistencës ndaj shkeljeve të integritetit, dhe rritja e efikasitetit, efektivitetit dhe transparencës së sistemit tërësor të menaxhimit komunal përmes përmirësimit të menaxhimit të funksionit të rrezikut të integritetit dhe përmirësimit të praktikave të menaxhimit të integruar</i>						
<b>Veprimi/masat</b>	<b>Njësia përgjegjëse</b>	<b>Njësia koordinuese/ palët partnere të interesit</b>	<b>Afati për zbatim</b>	<b>Treguesit e suksesit</b>	<b>Kosto financiare dhe burimi i financimit</b>	

**OBJEKTIVAT STRATEGJIKE 2**

*Mundësimi i mjedisit të brendshëm për të mbështetur proceset komunale të shëndosha nga aspekti i integritetit, përmes kontrolleve të optimizuara të integritetit në nivel të procesit strategjik dhe operacional dhe ndërtimit/forcimit të kapaciteteve, njohurive dhe aftësiwe lokale në menaxhimin e integritetit*

<b>Veprimi/masat</b>	<b>Njësia përgjegjëse</b>	<b>Njësia koordinues/pa lët partnere të interesit</b>	<b>Afati për zbatim</b>	<b>Treguesit e suksesit</b>	<b>Kosto financiare dhe burimi i financimit</b>

**OBJEKTIVI STRATEGJIK 3**

*Përmirësimi i mjedisit të jashtëm për të përforcuar dhe zgjeruar aspektet e integritetit në proceset e modernizimit dhe reformës përmes bashkërendimit të përmirësuar me qytetarët, bizneset dhe aktorët e tjerë kyç, komunikimit të strukturuar dhe efektiv; promovimit të transparencës dhe angazhimit të palëve të interesit; shpërndarjes së praktikave të mira dhe angazhimit të përbashkët*

<b>Veprimi</b>	<b>Institucioni përgjegjës</b>	<b>Institucioni koordinues</b>	<b>Afati për zbatim</b>	<b>Treguesit e suksesit</b>	<b>Kosto financiare dhe burimi i financimit</b>

